



UNIWIN

SHKURT
2026

BULETINI SPECIAL I UNIVERSITETIT NDËRKOMBËTAR DIMËROR - UNIWIN 2026

Të nderuar lexues,

Me kënaqësi të veçantë ju prezantojmë buletin special të edicionit të tretë të Universitetit Ndërkombëtar Dimëror – UNIWIN, përmes të cilit pasqyrohet me krenari dhe përkushtim organizimi i suksesshëm i kësaj ngjarjeje nga Universiteti “Haxhi Zeka”. Ky edicion dëshmon se UNIWIN tashmë është konsoliduar si një forum akademik ndërkombëtar, që shërben si pikëtakim i rëndësishëm për shkëmbimin e ideve, avancimin e dijes dhe forcimin e rrjeteve të bashkëpunimit ndëruniversitar. Gjatë këtij viti, UNIWIN bashkoi një gamë të gjerë pjesëmarrësish nga universitete vendore dhe ndërkombëtare, studentë të përkushtuar, profesorë, studiues dhe përfaqësues të institucioneve akademike e zhvillimore, të cilët ndanë përvojat e tyre dhe kontribuan në ndërtimin e perspektivave të reja.

Ky buletin ofron një përmbledhje të strukturuar të aktiviteteve, diskutimeve, prezantimeve dhe momenteve më domethënëse nga UNIWIN 2026, duke reflektuar ndikimin e kësaj platforme në avancimin e dijes, nxitjen e dialogut akademik dhe thellimin e partneriteteve ndërkombëtare.

 Për të qenë të përditësuar apo të informuar më shumë: www.unhz.eu

CEREMONIA HAPËSE E UNIVERSITETIT NDËRKOMBËTAR DIMËROR - UNIWIN 2026

Universitetit Ndërkombëtar Dimëror , UNIWIN 2026, ka nisur zyrtarisht me ceremoni të mirëseardhjejes në ambientet e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, nga Prof. dr. Armand Krasniqi, Rektor i Universitetit, Prof. dr. Edmond Beqiri, Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar, dhe MSc Arbërora Haxhija, Drejtoreshë e Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar. Ceremonia u pasqyrua nga prania e anëtarëve të Këshillit Drejtues të UHZ-së, dekanëve të fakulteteve, si dhe stafit akademik dhe administrativ të universitetit, duke reflektuar mbështetjen e fuqishme institucionale për bashkëpunimin akademik ndërkombëtar. Universiteti “Haxhi Zeka” mirëpriti rreth 70 studentë nga vende të ndryshme, të cilët u mblodhën në qytetin e Pejës për të marrë pjesë në një javë intensive aktivitete akademike, shkëmbimesh kulturore dhe mundësisht për rrjetëzim ndërkombëtar.

Edicioni i tretë 2026 i UNIWIN përfshiu gjashtë kurse ndërdisiplinore, të ligjëruara nga profesorë ndërkombëtarë, duke përfshirë:

Prof. Kesra Nermend – Poloni
Prof. Małgorzata Nermend – Poloni
Prof. Jiyan Kilic – Turqi
Prof. Victoria Vasary – Hungari
Prof. Ahm Shamsuzzoha – Finlandë
Prof. Gjore Nakov – Bullgari

Ligjëratat ndërkombëtare u zhvilluan në bashkëpunim të ngushtë me profesorët e Universitetit “Haxhi Zeka”, të cilët kontribuan me ekspertizën e tyre akademike:

Prof. Elvis Elezaj,
Prof. Fisnik Morina,
Prof. Merita Begolli,
Prof. Driton Sylqa,
Prof. Thelleza Latifi & Prof. Ibrahim Krasniqi.

UNIWIN 2026 mirëpriti studentë nga Polonia, Turqia, Bosnja, Hungaria, Shqipëria dhe Kosova, duke e kthyer programin në një qendër të gjallë ndërkombëtare për shkëmbim njohurish dhe bashkëpunim akademik.

Ky program vjetor kombinon në mënyrë unike të mësuarit virtual me përvojat akademike me prezencë fizike, duke ofruar një platformë të fuqishme për dialog ndërkulturor, rritje profesionale dhe zhvillim personal. Të dy javët e aktivitetit u zhvilluan fizikisht, duke u mundësuar studentëve të krijojnë njohje të reja dhe të fitojnë përvoja të vlefshme përmes ligjëratave, punëtorive, vizitave në terren dhe aktiviteteve kulturore.

Me theks të veçantë në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe mësimin përmes përvojës, UNIWIN 2026 vazhdon të forcojë lidhjet arsimore përtej kufijve dhe riafirmon rolin në rritje të Universitetit “Haxhi Zeka” në komunitetin akademik ndërkombëtar.





LËNDËT E OFRUARA NË EDICIONIN E TRETË TË UNIVERSITETIT NDËRKOMBËTAR DIMËROR - UNIWIN 2026

Gjatë Universitetit Ndërkombëtar Dimëror u ofrua një shumëllojshmëri kursesh të ligjëruara nga profesorët e Universitetit "Haxhi Zeka" dhe profesorë të përzgjedhur ndërkombëtar.		
NR.	Lënda	Ligjërues
1	"E ardhmja Eko-Dixhitale: Teknologjia e Gjelbër, Turizmi Inteligjent dhe Investimet e Qëndrueshme"	Prof. Ahm Shamsuzzoha & Prof. Fisnik Morina
2	"Mendimi Dizajnues për Inovacione në Turizëm"	Prof. Kesra Nermend & Prof. Elvis Elezaj
3	"Neurofeedback EEG në Përvojat e Turizmit dhe Mirëqenies"	Prof. Malgorzata Nermend & Prof. Thëllëza Latifi
4	"Ekonomia Qarkore për Turizëm të Qëndrueshëm: Politikat dhe Praktikat e Zhvillimit"	Prof. Ibrahim Krasniqi & Prof. Viktória Vásáry
5	"Ekonomia e Turizmit"	Prof. Jiyan Kiliç & Prof. Driton Sylqa
6	"Turizëm, Mikpritje dhe Shërbime Kulinarë të Qëndrueshme dhe Inovative"	Prof. Gjore Nakov & Prof. Merita Dauti Begolli

"E ARDHMJA EKO-DIXHITALE: TEKNOLOGJIA E GJELBËR, TURIZMI INTELIGJENT DHE INVESTIMET E QËNDRUESHME"

Prof. Ahm Shamsuzzoha & Prof. Fisnik Morina

Lënda dha një pasqyrë multidisiplinare dhe ndërsektoriale, me synim të pajisë studentët me njohuri dhe aftësi të avancuara në ndërfaqen e teknologjive të gjelbra, turizmit inteligjent dhe investimeve të qëndrueshme në epokën dixhitale. Në kontekstin e transformimeve klimatike globale, dixhitalizimit të industrisë së turizmit dhe prioritetëve të zhvillimit të qëndrueshëm, kursi ofroi një qasje të integruar që lidhi parimet e qëndrueshmërisë me zgjidhje teknologjike inovative, modele të reja të qeverisjes mjedisore dhe potencialin e financimit të gjelbër.

Pas përfundimit të kursit, studentët do të jenë në gjendje të:

- Shpjegojnë dhe analizojnë konceptet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm në kontekstin e epokës dixhitale.
- Vlerësojnë potencialin dhe ndikimin e teknologjive të gjelbra dhe zgjidhjeve inovative.
- Zbatojnë njohuritë mbi Turizmin Inteligjent dhe ekonominë qarkore për të dizajnuar modele të reja të menaxhimit të përvojave të vizitorëve dhe reduktimit të ndikimit mjedisor në sektorin e turizmit.
- Analizojnë lidhjen midis komunitetit lokal dhe ekoturizmit.
- Identifikojnë instrumente financiare dhe politika mbështetëse për investimet e gjelbra.
- Projektuesin dhe prezantojnë projekte të integruara për turizëm të qëndrueshëm, duke përdorur qasje praktike dhe studime konkrete rasti.
- Reflektojnë në mënyrë kritike mbi sfidat dhe trendet aktuale të industrisë.



"NE MARRIM HUA
TOKEN NGA FËMIJËT
TANË, JO NGA
PARAARDHËSIT
TANË."

~PROVERB INDIAN
AMERIKAN~



“MENDIMI DIZAJNUES PËR INOVACIONE NË TURIZËM”

Prof. Kesra Nermend & Prof. Elvis Elezaj

Lënda njohu studentët me metodologjinë e Mendimit Dizajnes (Design Thinking) një qasje inovative që kombinon empatinë për përdoruesin, mendimin ndërdisiplinor dhe prototipimin e shpejtë. Në kontekstin e turizmit, kjo metodë shërbeu si një mjet efektiv për dizajnimin e produkteve dhe shërbimeve të reja, krijimin e përvojave unike udhëtimi dhe zgjidhjen e sfidave brenda sektorit.

Pas përfundimit të kursit, studentët u paisen me njohurit si:

- Kuptuan dhe aplikuan procesin e Mendimit Dizajnes në turizëm dhe menaxhimin e destinacioneve.
- Identifikuan nevojat e përdoruesve dhe përcaktuan problemet që lidhen me turizmin duke përdorur një qasje të orientuar te njeriu.
- Zhvilluan zgjidhje kreative dhe inovative për sfidat e turizmit.
- Punuan në mënyrë efektive në ekipe gjatë procesit të dizajnit dhe inovacionit.
- Përdorën prototipimin e shpejtë për të testuar dhe përmirësuar idetë në kontekste reale turistike.



**“Inovacioni ndodh kur
guxojmë të provojmë,
të gabojmë dhe të
përmirësohemi
shpejt.”
— Tom Kelley—**



“NEUROFEEDBACK EEG NË PËRVOJAT E TURIZMIT DHE MIRËQENIES”

Prof. Malgorzata Nermend & Prof. Thëllëza Latifi

Ky kurs ofroi një hyrje ndërdisiplinore në neurofeedback-in bazuar në EEG dhe aplikimet e tij në rritje në turizëm, mirëqenie, mikpritje dhe dizajn përvojash. Studentët eksploruan se si matja e aktivitetit të trurit dhe biofeedback-u në kohë reale mund të përdoret për të kuptuar emocionet e udhëtarëve, për të vlerësuar mjediset rikuperuese, për të dizajnuar shërbime të mirëqenies dhe për të përmirësuar përvojën e mysafirëve në hotele, spa, retreat-e dhe destinacione turistike. Kursi kombinoi teori, demonstrime praktike, workshop-e interaktive dhe punë projektuale në grupe të vogla. Nuk kërkohej njohuri paraprake në neuroshkencë. Kurs ishte veçanërisht i përshtatshëm për studentë që kishin interes në: menaxhimin e turizmit, studimet e mirëqenies dhe spa-ve, psikologjinë e udhëtimit, inxhinierinë e përvojave, inovacionin në mikpritje, ndërveprimin njeri-teknologji dhe turizmin e qëndrueshëm.

Gjatë pjesëmarrjes në modul, studentët kanë arritur të:

- Kuptojnë konceptet bazë të EEG-së, frekuencat e valëve të trurit dhe parimet e neurofeedback-ut.
- Dallojnë sistemet EEG klinike nga ato për konsumatorë dhe të kuptojnë aplikimet e tyre në turizëm dhe mirëqenie.
- Zbatojnë konceptet e neurofeedback-ut në dizajnimin dhe vlerësimin e përvojave turistike dhe aktiviteteve relaksuese.
- Interpretimit të të dhënave bazë EEG dhe identifikimin e artefakteve të zakonshme gjatë regjistrimeve.
- Analizojnë përdorimin e EEG-së në kërkime turistike, përfshirë emocionet e vizitorëve, psikologjinë e mjedisit dhe branding-un e destinacioneve.
- Bashkëpunojnë në mënyrë efektive në ekipe ndërdisiplinore dhe ndërkombëtare.



**“Qëllimi i artit nuk është të përfaqësojë pamjen e jashtme të gjërave, por rëndësinë e tyre të brendshme.”
— Aristoteli —**



“EKONOMIA QARKORE PËR TURIZËM TË QËNDRUESHËM: POLITIKAT DHE PRAKTIKAT E ZHVILLIMIT”

Prof. Ibrahim Krasniqi & Prof. Viktória Vásáry

Ky kurs shqyrtoi se si parimet e ekonomisë qarkore (Circular Economy – CE) mund të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe të kontribuonin në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG). Studentët eksploruan politika, modele biznesi dhe strategji praktike që përmirësojnë efikasitetin e burimeve dhe ulën ndikimin mjedisor brenda sektorit të turizmit. Programi përfshiu analizën e kuadrove globale dhe të Bashkimit Evropian – si European Green Deal dhe Circular Economy Action Plan (CEAP) – dhe implikimet e tyre për destinacionet turistike dhe ndërmarrjet. Përmes studimeve të rasteve ndërkombëtare, studentët vlerësuan iniciativat e suksesshme të turizmit qarkor, identifikuan pengesat në zbatim dhe zhvilluan njohuri për kalimin nga praktikat lineare drejt sistemeve të qëndrueshme, rigjeneruese dhe reziliente të turizmit.


Pas përfundimit të këtij kursi, studentët arritën të zotërojnë aftësitë e mëposhtme:

- Shpjeguan konceptet dhe parimet kryesore të ekonomisë qarkore dhe rëndësinë e tyre për turizmin e qëndrueshëm.
- Vlerësuan politikat e BE-së dhe kuadrot globale si European Green Deal dhe CEAP në sektorin e turizmit.
- Analizuan iniciativat e suksesshme të turizmit qarkor dhe modelet inovative të biznesit.
- Vlerësuan rolin e teknologjisë, inovacionit dhe dixhitalizimit në mundësimin e zgjidhjeve qarkore.
- Zhvilluan rekomandime politike dhe strategji biznesi që mbështesin praktikat qarkore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit.



“Inovacioni dhe teknologjia janë ura që na çojnë drejt një turizmi qarkor dhe të qëndrueshëm.”

— Ken Webster —



“EKONOMIA E TURIZMIT”

Prof. Jiyan Kiliç & Prof. Driton Sylqa

Ekonomia e Turizmit shqyrton dimensionet ekonomike të turizmit duke analizuar se si aktivitetet turistike ndikojnë në ekonominë kombëtare dhe rajonale, përfshirë rolin e tyre në rritje, zhvillim dhe qëndrueshmëri. Ky kurs ofron studentëve një bazë në parimet themelore ekonomike dhe i aplikon ato në strukturën, funksionimin dhe dinamikën e industrisë së turizmit, me fokus në ofertën, kërkesën, ekuilibrin e tregut dhe konceptet e mirëqenies.

Rezultatet e të mësuarit:

- Kuptimi dhe aplikimi i parimeve themelore ekonomike brenda kontekstit të turizmit.
- Shpjegimi i strukturës dhe rolit ekonomik të industrisë së turizmit.
- Analizimi i ofertës, kërkesës dhe ekuilibrit të tregut në turizëm.
- Vlerësimi i ndikimit të çmimeve, të ardhurave dhe faktorëve ekonomikë në aktivitetin turistik.
- Kuptimi i turizmit të qëndrueshëm dhe kontributi i tij në zhvillimin ekonomik.
- Aplikimi i koncepteve të mirëqenies ekonomike, përfshirë tepricën e konsumatorit dhe të prodhuesit, në analizën e turizmit.
- Analizimi kritik i literaturës akademike në ekonominë e turizmit.

“Turizmi është më shumë se vizitë – është një motor ekonomik që gjeneron të ardhura, punësim dhe zhvillim të qëndrueshëm për destinacionet.”





“TURIZËM, MIKPRITJE DHE SHËRBIME KULINARË TË QËNDRUESHME DHE INOVATIVE”

Prof. Gjore Nakov & Prof. Merita Dauti Begolli


Kjo lëndë fokusohet në praktikat e qëndrueshme dhe inovative në turizëm, hotelieri dhe shërbime kulinare. Ajo integron trashëgiminë kulturore, gastronominë, menaxhimin e mikpritjes, ndërmarrësinë dhe zgjidhjet digjitale. Theksi vihet në qëndrueshmëri, inovacion dhe zhvillimin e aftësive praktike, me qëllim përmirësimin e përvojës turistike duke respektuar vlerat kulturore dhe mjedisore.

Studentët u pajisën me kompetenca për të zgjidhur probleme reale që lidheshin me:

- Identifikimin dhe vlerësimin e praktikave të qëndrueshme në sektorin e turizmit, hotelierisë dhe shërbimeve kulinare.
- Zbatimin e qasjeve inovative të menaxhimit për të rritur cilësinë e shërbimeve dhe konkurrueshmërinë.
- Integrimin e trashëgimisë kulturore dhe gastronomisë në planifikimin turistik dhe dizajnimin e shërbimeve.
- Përdorimin e mjeteve digjitale për përmirësimin e marketingut, ofrimit të shërbimeve dhe efikasitetit operacional.



“Turizmi i vërtetë nuk është vetëm të vizitosh vende, por të ruash historinë, të nxisësh inovacionin dhe të krijosh eksperiencë që qëndrojnë.”
— Bazuar në parimet e World Tourism Organization dhe UNESCO—







“TRADITA DHE INOVACIONI: PROF.DR.FATIH SÖNMEZ NË UNIWIN 2026”

Pjesëmarrësit e edicionit të tretë të UNIWIN 2026 patën mundësinë të ndjekin dy ligjërata të veçanta nga Prof. Dr. Fatih Sönmez, të cilat u zhvilluan gjatë dy ditëve të universitetit dimëror dhe ofruan njohuri të vlefshme mbi turizmin dhe zhvillimin ekonomik lokal.

1. Turizmi Shëndetësor: Koncepte, Mundësi dhe Roli në Zhvillimin e Qëndrueshëm
Në këtë ligjëratë, Prof. Dr. Fatih Sönmez prezantoi konceptet kryesore të turizmit shëndetësor, duke theksuar rëndësinë e tij si një sektor me potencial të madh për zhvillim ekonomik dhe inovacion. Pjesëmarrësit u njohën me mundësitë që ofron turizmi shëndetësor, praktikatat ndërkombëtare të suksesshme dhe mënyrat se si ky sektor mund të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social në Kosovë. Ligjërata ofroi një platformë për diskutime mbi strategjitë për promovimin e turizmit shëndetësor dhe integrimin e tij me sektorët lokalë dhe ndërkombëtarë.

2. Prodhimi i Produkteve Vendore me Vlerë të Shtuar nga Bimët Lokale
Në sesionin e dytë, Prof. Dr. Fatih Sönmez u fokusua në prodhimin e produkteve vendore me vlerë të shtuar, duke lidhur njohuritë tradicionale me teknikat moderne të prodhimit dhe sipërmarrjes. Ligjërata solli shembuj konkret të produkteve të punuara nga bimët vendore dhe mënyrat se si ato mund të zhvillohen si produkte me potencial ekonomik, duke krijuar mundësi për sipërmarrësit lokalë dhe duke fuqizuar ekonominë e komuniteteve vendore. Pjesëmarrësit u frymëzuan nga praktikatat e propozuara dhe diskutimet mbi mënyrat e inovacionit dhe zhvillimit të produkteve tradicionale.

Të dy sesionet ngjallën interes të madh dhe diskutime aktive midis studentëve dhe stafit akademik, duke forcuar frymën ndërdisiplinore dhe ndërkombëtare të UNIWIN 2026.



“ERASMUS+ KOSOVË: LIGJËRATË INFORMUESE PËR PJESËMARRËSIT E UNIWIN 2026”

Studentët dhe stafi akademik patën mundësinë të marrin pjesë në një ligjëratë të veçantë të mbajtur nga Mimika Dobrosht, përfaqësuese e Zyrës Erasmus+ në Kosovë.

Gjatë prezantimit, zonja Dobrosht informoi pjesëmarrësit rreth rolit dhe misionit të Zyrës Erasmus+ në Kosovë, duke përfshirë:

- Programet Erasmus+ dhe mundësitë që ato ofrojnë për studentët dhe institucionet e arsimit të lartë.
- Instrumentet e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe lëvizshmërisë akademike.
- Rëndësinë e partneriteteve institucionale midis Kosovës dhe institucioneve evropiane të arsimit të lartë.

Temë kryesore e ligjëratës ishte: “Forcimi i Bashkëpunimit Evropian–Kosovë në Arsimin e Lartë përmes Erasmus+”, duke theksuar mënyrat se si bashkëpunimi ndërkombëtar dhe programet Erasmus+ mund të nxisin zhvillim akademik dhe profesional për studentët dhe stafin akademik.

Ky sesion ngjalli interes të madh tek pjesëmarrësit dhe kontribuoi ndjeshëm në frymën ndërkombëtare dhe ndërdisiplinore të UNIWIN 2026, duke forcuar vetëdijen për Erasmus+ si një instrument kyç për avancimin e arsimit të lartë në Kosovë.



“EKSPLOKIM DHE ZHVILLIM: GUEST LECTURE MBI TURIZMIN E PEJËS – UNIWIN 2026”

Në kuadër të UNIWIN 2026, studentët dhe stafi akademik patën mundësinë të ndjekin një ligjëratë të ftuar nga Zyra e Turizmit e Komunës së Pejës me temën: “Tourism – Potential for Economic Development of Kosovo”. Ligjërata u mbajt nga Virtyt Morina, Blerta Harxhi Begolli & Jakob Hook, të cilët prezantuan para studentëve dhe profesorëve vendorë dhe ndërkombëtarë pasuritë natyrore dhe kulturore të Pejës, si dhe vizionin institucional për zhvillimin e saj si një destinacion turistik atraktiv. Pjesëmarrësit u njohën me potencialin e turizmit malor, kulturor dhe aventuror, mundësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar, dhe ndikimin pozitiv që zhvillimi i turizmit ka në ekonominë lokale dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Ky sesion ngjalli interes të madh dhe diskutime aktive, duke forcuar lidhjen ndërmjet akademisë dhe institucioneve lokale, dhe duke promovuar Kosovën dhe Pejën si destinacione me potencial të jashtëzakonshëm zhvillimor dhe turistik. UNIWIN 2026 vazhdon të shërbejë si një platformë ndërkombëtare për ndërlidhjen e dijes akademike me praktikën institucionale, duke theksuar rolin e turizmit si një mundësi reale për rritje ekonomike dhe bashkëpunim ndërkombëtar.



AKTIVITETET GJATË UNIWIN 2026

Profesorët dhe studentët pjesëmarrës në UNIWIN patën mundësinë të shkëputen nga ligjëratat për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të organizuara nga Universiteti "Haxhi Zeka". Këto aktivitete, të ndryshme në natyrë, synonin gjithmonë të ndërtonin përvoja të përbashkëta dhe të pasurojnë mësimin jashtë salle.

Në kolazhin e mëposhtëm, mund të shihni disa nga momentet më të veçanta të këtyre aktiviteteve të ndërthurura.





“UNIWIN ZBULON GRYKËN E RUGOVËS PËRMES HAPAVE TË STUDENTËVE”

Në kuadër të aktiviteteve të programit UNIWIN, studentët zhvilluan një vizitë njëditore në Grykën e Rugovës, një nga destinacionet më të njohura natyrore dhe kulturore të Pejës. Ky aktivitet u konceptua si një mundësi për të integruar njohuritë teorike me praktikën, duke vlerësuar peizazhet, historinë dhe trashëgiminë kulturore të zonës. Gjatë vizitës, pjesëmarrësit eksploruan rrugë malore, formacione natyrore dhe pika historike, duke kuptuar rolin e turizmit kulturor dhe natyror në zhvillimin lokal. Përmes këtij udhëtimi, studentët përjetuan një eksperiencë multidimensionale, ku teoritë e mësuara në ligjërata u pasuruan nga kontakti direkt me ambientin dhe komunitetin lokal. Kjo përvojë jo vetëm që forcoi njohuritë mbi trashëgiminë dhe ekosistemet e rajonit, por edhe kontribuoi në ndërtimin e aftësive analitike dhe perceptuese, duke e bërë Grykën e Rugovës një vend të paharrueshëm për mësimin praktik dhe promovimin e vlerave kulturore.





“TAKIMI ME KAMPIONËT OLIMPIKË & BOTËRORË NË PEJË”

Pjesëmarrësit e UNIWIN 2026 vizituan ekipin kombëtar të xhudos së Kosovës dhe ndoqën nga afër përgatitjet e kampionëve botërorë dhe olimpike si Drita Krasniqi, Akil Gjakova dhe Laura Fazliu, të udhëhequr nga trajnerët e shquar Driton “Toni” Kuka dhe Majlinda Kelmendi. Ky takim forcoi lidhjet midis sportit dhe arsimit, duke ofruar një eksperiencë unike për studentët ndërkombëtarë dhe duke nxjerrë në pah respektin dhe bashkëpunimin mes ekipit. Takimi krijoi një urë të fuqishme midis arsimit dhe sportit, duke nxjerrë në pah respektin, bashkëpunimin dhe frymën konkurruese që bashkon studentët dhe kampionët. Studentët ndërkombëtarë u frymëzuan nga historia e suksesit dhe energjia e ekipit, duke kuptuar rëndësinë e disiplinës, punës ekipore dhe pasionit për të arritur majat.

UNIWIN 2026 – ku dija takon kampionët!










“UNIWIN 2026 VIZITON ONIX SPA – TRADITË, SHËNDET DHE INSPIRIM PËR STUDENTËT”

Pjesëmarrësit e UNIWIN 2026 vizituan Onix Spa Thermal Resort, një qendër rehabilituese me histori shumëshekullore, ku ujërat termo-mineralë përdoren që nga kohët e ilirëve, romakëve dhe osmanëve. Ata patën mundësinë të njihen me shërbimet rehabilituese, hidro- dhe fizioterapi, si dhe me teknologjitë moderne dhe ambientin relaksues që kombinon traditën natyrore me kujdesin për mirëqenie. Përfaqësuesit e Onix Spa prezantuan objektivat dhe shërbimet që ofrojnë, duke e bërë këtë vizitë një eksperiencë të vlefshme për mirëqenie, relaksim dhe turizëm shëndetësor në rajonin e Pejës.









“NJË UDHËTIM NË TRASHËGIMINË E PEJËS ME Pjesëmarrësit e UNIWIN”

Në shoqërim me Prof. Alberta Tahiri, pjesëmarrësit e Programit të Shkollës Dimërore **UNIWIN** zhvilluan një ekskursion edukativ në zemër të qytetit të Pejës. Ata u takuan në oborrin e fakultetit dhe filluan një udhëtim këmbësor që i çoi drejt disa nga vendet më të rëndësishme historike dhe kulturore të qytetit, duke përfshirë:

- **Tregu i Vjetër**, një qendër tradicionale që ruan atmosferën dhe zanatet e vjetra të qytetit.
- **Çarshi Xhamia**, simbol i arkitekturës dhe trashëgimisë fetare të Pejës.
- **Mulliri i Haxhi Zekës**, një monument historik që dëshmon për zhvillimin ekonomik dhe social të komunitetit.
- **Muzeu i Pejës**, ku pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen me ekspozitat që pasqyrojnë kulturën, historinë dhe traditat e qytetit.

Ky aktivitet edukativ ofroi jo vetëm një eksperiencë të pasur kulturore, por edhe mundësinë për të lidhur njohuritë teorike me përvojën praktike, duke fuqizuar vlerat akademike dhe interaktive të mësimin në terren. Përmes këtij udhëtimi, pjesëmarrësit thelluan kuptimin e trashëgimisë historike dhe rëndësinë e ruajtjes së identitetit kulturor të Pejës.









“EKSPORIM KULTUROR NË VENDLINDJEN E MEHMET AKIFIT – SHUSHICË”

Në kuadër të aktiviteteve të programit **UNIWIN**, pjesëmarrësit zhvilluan një vizitë edukative në **Shushicë, vendlindjen e Mehmet Akifit**, autorit të **Himnit Kombëtar Turk** dhe figurës së njohur të letërsisë dhe edukimit. Mehmet Akifi konsiderohet një **poet, edukator** dhe aktivist i shquar, i përkushtuar në promovimin e identitetit kombëtar dhe vlerave shoqërore, duke lënë gjurmë të rëndësishme në historinë kulturore dhe intelektuale të rajonit. Vizita ofroi mundësinë për të kuptuar ambientin dhe kontekstin historik ku ai u rrit, si dhe **rrejtë** e origjinës së tij **familjare**.

Qëllimi i vizitës ishte njohja e trashëgimisë kulturore dhe historike të vendit dhe thellimi i kuptimit mbi rolin e figurave intelektuale në zhvillimin e shoqërisë dhe edukimin kombëtar. Pjesëmarrësit eksploruan **vendlindjen** e Mehmet Akifit, duke kuptuar influencën e kontekstit social dhe **historik** mbi veprën dhe angazhimin e tij për identitetin dhe vlerat shoqërore.

Ky aktivitet nuk ishte vetëm një **udhëtim kulturor**, por një eksperiencë edukative e gjallë, ku njohuritë teorike u lidhën me përvojën praktike dhe vizuale në terren. Përmes këtij udhëtimi, pjesëmarrësit thelluan njohuritë mbi letërsinë, historinë dhe kulturën kombëtare, duke forcuar vlerat akademike dhe interaktive të mësimin në kuadër të UNIWIN.





“STUDENTËT E UNIWIN EKSPLORUAN TRASHËGIMINËN DHE BUKURINË NATYRALE TË SHPELLËS ‘BUKUROSHJA E FJETUR’”

Pjesëmarrësit e programit UNIWIN zhvilluan një vizitë në Shpellën “Bukuroshja e Fjetur”, një nga atraksionet më të njohura natyrore dhe historike të Radavcit. Ky vend tërheq vizitorët jo vetëm për bukurinë e formacioneve gjeologjike, por edhe për legendat dhe historinë që lidhen me emrin e saj, duke e kthyer çdo hap në një mësim mbi trashëgiminë kulturore dhe natyrore të rajonit.

Studentët patën mundësinë të hynin brenda shpellës dhe të eksploronin stalaktitet, stalagmitet dhe peizazhet nën tokë, duke përjetuar një përvojë praktike që lidhi teorinë e mësuar në ligjërata me terrenin.

Aktiviteti nxiti kureshtjen dhe reflektimin mbi rëndësinë e ruajtjes së vlerave natyrore dhe promovimit të turizmit edukativ. Përmes këtij udhëtimi, pjesëmarrësit forcuan aftësitë analitike dhe perceptuese, ndërkohë që mësuan të vlerësojnë një prej perlatave natyrore më të rëndësishme të Pejës, duke e bërë vizitën një përvojë të paharrueshme dhe inspiruese për të gjithë programin UNIWIN.



“REFLEKTIMET E PJESËMARRËSVE GJATË UNIVERSITETIT NDËRKOMBËTAR DIMËROR 2026”

Dear students and colleagues, I spent a short time with you at Uniwin, but it was a very great and enjoyable time. Thanks to everyone 🙏, and I hope to see you again soon...❤️
Prof. Fatih

LIVE

Dear students and colleagues,
Thank you for your active participation in our lectures.
I hope we will meet again, and perhaps you will visit Bulgaria one day.
Best wishes to all!
Prof.Gjore



My dear fellow students, I greet you from the bottom of my heart ❤️
You have been wonderful throughout this time. I will miss you very much!
I love you and wish you endless success in every step of your academic and professional journey. ✨

Also, a special thank you to the national and international professors of the UNIWIN Winter School.

With your dedication, professionalism, and inspiration, you have provided us not only with academic knowledge, but also with motivation to move forward with vision and responsibility. It was an honor and a privilege to learn from you.

Grateful for this unforgettable experience! 🌍✨
Selva

Omer Honsic,

I would like to sincerely thank you for the knowledge, experience and dedication you generously shared throughout the UNIWIN Winter School. Your openness, professionalism, and willingness to collaborate made this experience truly valuable for me.

It was an honor to learn from all of you, to exchange ideas and to work in an environment that fosters quality, mutual respect and genuine academic exchange. Every class and conversation left a strong and positive impression to me.

Thank you for the inspiration, support and positive energy you brought.

I will carry this experience as a meaningful memory and an important part of my life

All the best



In this Session of the UNIWIN 2026 Winter University, for me as a student at the Master's level in Management and Sustainable Tourism, I have had an extremely good experience. I thank the Staff and Management of UNIWIN.it for a perfect organization, as well as the Professors who lectured in the 3rd Session of UNIWIN.it.

Kushtra

Dear Professors and Students

It is with great appreciation that I thank you all for your dedication hard work and continuous support organizing this event for the third year in a row is a proud achievement that reflects our unity commitment and shared vision for excellence your contribution makes our university stronger and more inspiring every day I am truly grateful to be part of this academic community

thank you sincerely for everything ❤️
Soreja

Recommendation - International Winter University (UNIWIN)

I had the opportunity to participate in the 3rd International Winter University (UNIWIN) programme in Peja, Kosovo, and I can confidently recommend it both to prospective international students and to academic institutions seeking meaningful international cooperation opportunities.

The programme offers a well-structured academic curriculum focusing on contemporary topics such as sustainable tourism, circular economy policies, tourism economics, design thinking for innovation, green technologies, smart tourism development, and emerging fields like neurofeedback applications in wellness and tourism. The interdisciplinary approach makes it especially valuable for students interested in international relations, public policy, sustainability, tourism studies, and regional development.

Beyond the academic content, the programme provides a truly international learning environment where students can build professional networks, exchange ideas, and develop intercultural competencies. The welcoming atmosphere, strong sense of community, and excellent organisation contribute greatly to the overall experience.

Practical activities and cultural programmes are an important part of UNIWIN. Visits such as the Bogë ski resort excursion, the Peja City Museum, meetings with Olympic judo champions and their coaching team, and lectures on higher education internationalisation provided unique insights into Kosovo's culture, society, and tourism potential. These experiences complement the academic component and make the programme both professionally valuable and personally memorable.

From an institutional perspective, UNIWIN represents a strong example of international academic cooperation, combining high-quality teaching, practical engagement, and cultural exchange. It offers excellent opportunities for universities to strengthen partnerships, promote student mobility, and support interdisciplinary collaboration.

Importantly for prospective participants, accommodation and meals were fully provided during the two-week programme, and the organisers ensured a supportive and well-coordinated environment throughout our stay.

Based on my experience, I strongly encourage students looking for an enriching international academic experience, as well as universities interested in internationalisation and regional cooperation, to consider participation in future UNIWIN programmes. If you have any questions about the programme or student experience, please feel free to contact me at herbak.asztrik.benjamin@stud.uni-nke.hu.

I sincerely hope the programme will continue to grow and attract even more international participants in the years ahead.

Asztrik Benjamin Herbak

Ludovika University of Public Service, Budapest
M.A. in International Public Service Relations



Përfundon me sukses Universiteti Ndërkombëtar Dimëror - UNIWIN 2026

Universiteti "Haxhi Zeka" përmbylli me sukses edicionin e tretë të Universitetit Ndërkombëtar Dimëror UNIWIN 2026, duke shënuar një ngjarje të rëndësishme akademike ndërkombëtare dhe duke ofruar mundësinë për bashkëpunim me profesorë dhe studentë nga vende të ndryshme. Universiteti dimëror ofroi përvoja të reja, frymëzuese dhe të vlefshme, duke forcuar më tej bashkëpunimin akademik dhe ndërkulturor.

Gjatë këtij edicioni u organizuan gjashtë kurse akademike:

- Eco-Digital Futures: Green Tech, Smart Tourism & Sustainable Investment,
- Sustainable and Innovative Tourism, Hospitality and Culinary Services,
- Tourism Economy,
- Design Thinking for Tourism Innovations,
- Neurofeedback EEG in Tourism & Wellness Experiences,
- Circular Economy for Sustainable Tourism: Policies and Development Practices.

Këto kurse u ligjëruan nga profesorë të njohur të Universitetit "Haxhi Zeka": Prof. Elvis Elezaj, Prof. Fisnik Morina, Prof. Merita Begolli, Prof. Driton Sylqa, Prof. Thelleza Latifi dhe Prof. Ibrahim Krasniqi, si dhe nga profesorë të dalluar ndërkombëtarë: Prof. Kesra Nermend, Prof. Malgorzata Nermend, Prof. Jiyan Kilic, Prof. Victoria Vasary, Prof. Ahm Shamsuzzoha dhe Prof. Gjore Nakov.

Pjesë e programit ishin edhe ligjëratat e ftuara:

- Prof. Dr. Fatih Sönmez prezantoi ligjëratën "Prodhimi i produkteve me vlerë të shtuar nga bimët vendore".
- Zyra e Turizmit e Komunës së Pejës mbajti ligjëratën "Turizmi – potencial për zhvillimin ekonomik të Kosovës", të prezantuar nga Virtyt Morina, Blerta Harxhi Begolli dhe Jakob Hook, duke theksuar vlerat natyrore dhe kulturore të Pejës dhe potencialin e saj për zhvillim ekonomik përmes turizmit.
- Mimika Dobroshi, përfaqësuese e Zyrës Erasmus+ në Kosovë, prezantoi misionin, aktivitetet dhe mundësitë që ofron programi Erasmus+ për studentët dhe stafin akademik.

Pjesëmarrësit gjithashtu morën pjesë në vizita studimore dhe aktivitete të ndryshme, duke përfshirë: Rugovën, Onix Spa Center, Shpellën Bukuroshja e Fjetur, Qendrën Kombëtare të Xhudos, Hamamin e Pejës, Muzeun e Qytetit dhe shumë lokacione të tjera me rëndësi kulturore dhe turistike.

**FALEMINDERIT QË LEXUAT BULETININ INFORMUES TË
UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA"!**

**NE VLERËSOJMË ANGAZHIMIN DHE MBËSHTETJEN TUAJ PËR
UNIVERSITETIN TONË. QËNDRONI TË PËRDITËSUAR ME TË REJAT
MË TË FUNDIT, EVENTET DHE ARRITJET AKADEMIKE DUKE NA
NDJEKUR NË PLATFORMAT TONA ZYRTARE.**



 www.unhz.eu



 facebook



 whatsapp



 viber



 Tiktok



 Instagram

 **PËR ÇDO PYETJE APO SUGJERIM, NA SHKRUANI NË:
UNIWIN@UNHZ.EU**